



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P-153
Prishtinë, 13 shkurt 2014

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 13 SHKURT 2014**

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup Krasniqi, ndërsa i ndihmuan nënkryetarët Sabri Hamiti dhe Glauk Konjufca.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së parë plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Halit Krasniqi, Skënder Hyseni, Faton Topalli, Donika Kadaj-Bujupi, Myzejene Selmani, Nait Hasani, Hykmete Bajrami, Florin Krasniqi dhe Goran Marinković, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Xhafer Tahiri parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje me atë se cilat janë programet dhe politikat e Qeverisë së Kosovës për vitin 2014 lidhur me zvogëlimin e e varfërisë në Kosovë.

Kryeministrin Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Xhafer Tahiri parashtroi pyetje për ministrin Nenad Rashiq në lidhje me atë se sa është shkalla e varfërisë në mesin e të rinjve dhe grave në Kosovë.

Ministri Nenad Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetit Xhafer Tahiri.

Deputeti Halit Krasniqi parashtroi pyetje për ministrin Agim Çeku në lidhje me sfidat dhe afatin kohor të përfundimit të punës së Komisionit për verifikimin e statusit të veteranëve, invalidëve, pjesëtarëve dhe të internuarve të UÇK-së.

Ministri Agim Çeku nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Kymete Bytyçi parashtroi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi në lidhje me masat e ndërmarra nga ministria që ai drejton lidhur me përmirësimin e kushteve për Policinë e Kosovës.

Ministri Bajram Rexhepi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Halit Krasniqi parashtroi pyetje për ministrin Fadil Ismajli në lidhje me angazhimet e ministrisë që ai drejton lidhur me vlerësimin e shqetësimeve të konsumatorëve të energjisë elektrike.

Ministri Fadil Ismajli nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Alma Lama parashtroi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi në lidhje me atë nëse e ka shteti i Kosovës listën e organizatave që i konsideron terroriste.

Ministri Bajram Rexhepi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Alma Lama parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me ofrimin e shërbimeve shëndetësore për banorët e fshatrave Bistricë, Cerajë dhe Koshutovë të komunës së Leposaviqit.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me zbatimin e Ligjit për duhanin.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Rita Hajzeraj-Beqaj.

Deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj parashtroi pyetje për ministrin Nenad Rashiq në lidhje me zbatimin e Ligjit për të verbrit dhe kur do t'u jepet kompensimi retroaktiv për vitin 2013.

Ministri Nenad Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetes Rita Hajzeraj-Beqaj.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtroi pyetje për zv/kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje me masat që i ka ndërmarrë ministria e Drejtësisë për parandalimin e mbajtjes së zgjedhjeve nga Qeveria e Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës.

Zv/kryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Albana Gashi parashtroi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi në lidhje me çfarë baze ligjore është urdhëruar Policia e Kosovës që të futet në mjediset e Universitetit të Prishtinës gjatë protestave të një grupi studentësh para disa ditëve.

Ministri Bajram Rexhepi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Kymete Bytyçi parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me arsyet e mungesës së disa aparateve në Spitalin Rajonal të Pejës.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Kymete Bytyçi.

Deputeti Daut Haradinaj parashtroi pyetje për ministrin Agim Çeku në lidhje me atë se a do ta marrin statusin e veteranit të luftës së UÇK-së personat e UDB-së, të infiltruar në UÇK. Ministri Agim Çeku nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Bekim Haxhiu parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me arsyet e suspendimit nga detyra të Basri Rexhës, kryeinspektor i Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Bekim Haxhiu.

Deputeti Bekim Haxhiu parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me arsyet e mosnënshkrimit të udhëzimit administrativ për përcaktimin e kompetencave profesionale dhe gradimin në sistemin e pagave për një pjesë të stafit shëndetësor.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetit Bekim Haxhiu.

* * *

Në vazhdim, lidhur me rendin e ditës, për fjalë u paraqit deputeti Arben Gashi.

Arben Gashi, në emër të GP të LDK-së, propozoi që nga rendi i ditës së punimeve të mbledhjes së sotme të hiqet pika - Shqyrtimi i dytë i Projektligji për skemat pensionale të financuara nga Shteti, dhe ky projektligj t'i kthehet Komisionit Funkcional për rishqyrtim. Fjala e plotë e deputetit Arben Gashi është dhënë e plotë në transkript.

Në lidhje me propozimin e deputetit Arben Gashi, kryetari kërkoi deklaratimet e grupeve parlamentare.

Për propozimin e lartpërmendur u deklaruan deputetët: Flora Brovina, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Faton Topalli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Daut Haradinaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Sasha Milosavljeviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mufera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe ministri Nenad Rashiq, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryetari e hodhi në votim propozimin e paraqitur nga deputeti Arben Gashi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 60,
Kundër ----- 11,
Abstenime ----- 2.

Kryetari më pas konstatoi se Kuvendi e mori këtë:

V E N D I M

Projektligji nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga Shteti i kthehet për ripunim Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

* * *

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Shqyrtimi i propozim-programit të punës së Kuvendit për vitin 2014,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrimin e bujqësisë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin mjekësor emergjent,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetin mendor,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligji për sigurimin shëndetësor,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës,
11. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie.

* * *

3. Shqyrtimi i propozim-programit të punës së Kuvendit për vitin 2014

Kryetari në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës tha se programi i punës së Kuvendit për vitin 2014 paraqet dokument bazë të Kuvendit për aktivitetin e organit ligjvënës të Republikës së Kosovës. Ky program, tha ai, është hartuar duke u bazuar në këto dokumente:

- Dokumenti i Qeverisë për Strategjinë Legjislative për vitin 2014,
- Planet e punës së komisioneve parlamentare për vitin 2014,
- Plani i Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e propozim-programit të punës së Kuvendit për vitin 2014.

Vjosa Osmani, në emër të Komisionit për Integritet Evropian, kërkoi që propozim-programi i punës së Kuvendit për vitin 2014 të plotësohet edhe me disa projektligje që kanë të bëjnë me çështjen e integriteteve evropiane. Diskutimi i znj. Vjosa Osmani është dhënë i plotë në transkript.

Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës diskutoi edhe nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, i cili propozoi që propozim-programi i punës së Kuvendit për vitin 2014 të plotësohet dhe më pas të shqyrtohet në njërin nga mbledhjet plenare të radhës. Diskutimi i z. Sabri Hamiti është dhënë i plotë në transkript.

Në vazhdim, kryetari e hodhi në votim propozimin për plotësimin e programit të punës së Kuvendit për vitin 2014.

Kryetari konstatoi se programi i punës së Kuvendit për vitin 2014 duhet të plotësohet me propozimet e Komisionit për Integritet Evropian dhe të procedohet për miratim në seancë plenare.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrimin e bujqësisë

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrimin e bujqësisë.

Ministri **Blerand Stavileci** tha se ky Projektligj përcakton përmbajtjen, organizimin dhe zbatimin e regjistrimit të bujqësisë në vitin 2014 në tërë territorin e Republikës së Kosovës, përbërjen, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të cilat e kryejnë regjistrimin e ekonomive familjare, krijimin e bazës së të dhënave - regjistrin bujqësor, publikimin e të dhënave, periudhën e mbledhjes, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave që dalin nga ky regjistrim, mënyrën dhe formën e publikimit dhe shpërndarjes dhe ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave individuale të regjistrimit.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Blerand Stavileci është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrimin e bujqësisë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Nait Hasani, në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor; Ramiz Lladrovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Salih Morina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Faton Topalli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Rasim Demiri, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Nijazi Idrizi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrimin e bujqësisë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 62,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrimin e bujqësisë.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror.

Ministri Fehmi Mujota tha se ky projektligj parasheh formimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve të trafikut ajror me qëllim që të arrihet efikasiteti, të përdoren më mirë teknologjitë e reja, të përshejtohen përpjekjet për modernizim dhe që t'u përgjigjet më me efektivitet nevojave të grupeve të interesit që udhëtojnë me transport ajror, ose bartin mallra.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Fehmi Mujota është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; Sala Berisha Shala, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Fikrim Damka, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Zenun Pajaziti, Sabri Hamiti dhe ministri Fehmi Mujota, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 60,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 9.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin mjekësor emergjent

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Shërbimin mjekësor emergjent.

Ministri Ferid Agani tha se ky projektligj përcakton kushtet, organizimin dhe mënyrën e funksionimit të Shërbimit mjekësor emergjent, i cili organizohet si fushë e veçantë e veprimtarisë shëndetësore me qëllim të ofrimit të kujdesit mjekësor emergjent për qytetarët të cilëve për shkak të sëmundjes apo lëndimit u është rrezikuar drejtpërdrejt jeta, deri në fillimin e procesit të trajtimit përfundimtar.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Ferid Agani është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për Shërbimin mjekësor emergjent.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Fikrim Damka, në emër të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale; Salie Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Bahri Thaçi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Faton Topalli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Jeton Svirca, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Mufera Shinik - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Shaip Muja, Nazane Breca, Aurora Bakalli, Emilija Rexhepi, Halit Krasniqi, Hatim Baxhaku, Fatmir Xhelili, Haki Demolli, Armend Zemaj, Bekim Haxhiu dhe ministri Ferid Agani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për Shërbimin mjekësor emergjent.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 64,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Shërbimin mjekësor emergjent.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetin mendor

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për shëndetin mendor.

Ministri Ferid Agani tha se ky projektligj ka për qëllim vendosjen e rregullave bazike në shëndetin mendor, mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen me këtë lëmi, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Ferid Agani është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për shëndetin mendor.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Fikrim Damka, në emër të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale; Flora Brovina, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Nazane Breca, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Faton Topalli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Jeton Svirca, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Mufera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Ganimete Musliu, Halit Krasniqi, Fatmir Xhelili, Shaip Muja, dhe ministri Ferid Agani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për shëndetin mendor.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 64,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për shëndetin mendor.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Ministri Nenad Rashiq tha se qëllimi i këtij projektligji është mbështetja ligjore dhe institucionale për rritjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës, si dhe trajtimin e mundësive të barabarta përfshirë edhe mundësitë gjinore.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Nenad Rashiq, është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Fikrim Damka, në emër të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale; Salie Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Nazane Breca, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Faton Topalli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Suzan Novobërdaliu, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Mufera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Flora Brovina, Kymete Bajraktari, Agim Kuleta, Ganimete Musliu, Halit Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 64,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligji për sigurimin shëndetësor

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për sigurimin shëndetësor.

Ministri Ferid Agani tha se ky projektligj ka për qëllim sigurimin e qasjes universale të qytetarëve të Republikës së Kosovës ndaj shërbimeve kualitative të kujdesit themelor shëndetësor për përmirësimin e treguesve shëndetësor dhe sigurimit të mbrojtjes financiare nga varfërimi për shkak të shpenzimeve të mëdha për kujdesin shëndetësor nëpërmjet themelimit dhe rregullimit të sistemit publik të sigurimit shëndetësor.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e z. Ferid Agani është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për sigurimin shëndetësor.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Fikrim Damka, në emër të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale; Flora Brovina, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Bahri Thaçi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Faton Topalli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Jeton Svirca, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Fikrim Damka, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Mursel Haljilji, në emër të Grupit Parlamentar SLS, si dhe Shaip Muja, Muhamet Mustafa, Visar Ymeri, Sevdije Lama, Justina Shiroka- Pula, Nazane Breca, Blerta Deliu-Kodra, Suzan Novobërdaliu, Vjollca Krasniqi, Salie Mustafa, Aurora Bakalli, Halit Krasniqi, Bekim Haxhiu dhe ministri Ferid Agani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për sigurimin shëndetësor. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 63,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për sigurimin shëndetësor.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Deputeti Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e paraqiti para deputetëve raportin me rekomandime.

Kryesuesi më pas hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, dhe 24.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----63 ,
Kundër----- 0 ,
Abstenime----- 0 .

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 04/L-226 ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës.

11. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media

Kryetari kërkoi nga deputetët që nëpërmjet një votimi formal me ngritje dore të votojnë propozimin e grupeve parlamentare për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Komisionit të Pavarur për Media.

Kuvendi me shumicë votash e miratoi formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Komisionit të Pavarur për Media.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media, në këtë përbërje:

1. Xhevahire Izmaqi, nga GP PDK, kryesuese,
2. Salih Morina, nga GP LDK, zv/kryesues i parë,
3. Jelena Bontiq nga GP SLS, zy/kryesuese e dytë,
4. Ramë Vataj, nga GP PDK, anëtar,
5. Sadri Ferati, nga GP LDK, anëtar,
6. Albulena Haxhiu, nga GP Lëvizja “Vetëvendosje” anëtare,
7. Teuta Haxhiu, nga GP AAK, anëtare,
8. Jeton Svirca, nga GP KKR, anëtar,
9. Albert Kinolli, nga GP “6+”, anëtar.

II. Ngarkohet Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media që të veprojë në përputhje me nenin 11, paragrafi 2.3 të Ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Media dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

* * *

Kryetari i mbylli punimet e mbledhjes së sotme në orën 19:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale